



## GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË QËNDRON NË MAJËN E PIRAMIDËS GJYQËSORE. AJO SIGURON DHËNIEN E BARABARTË DHE TË PAANSHME TË DREJTËSISË PËR TË GJITHË QYTETARËT NË VEND DHE VENDOS STANDARDET E NJË GJYKIMI TË DREJTË. GJYKATA E LARTË E USHTRON PUSHTETIN NË PËRPUTHJE ME PARASHIKIMET KUSHTETUESE DHE LIGJIN.

PARIMET THEMELORE QË E UDHËHEQIN GJYKATËN E LARTË NË VEPRIMTARINË E SAJ GJYQËSORE JANË: PAVARËSIA, PAANËSIA, EFIKASITETI, BARAZIA, DREJTËSIA, BESUESHMËRIA, LLOGARIDHËNIA DHE AKSESI TRANSPARENT NË DREJTËSI PËR TË GJITHË.

### SI FUNKSIONON GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Si gjykata më e lartë në vend, Gjykata e Lartë mbulon të gjithë territorin e vendit. Selia e saj është në Tiranë.

Ajo shqyrton rekursat kundër vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme të shkallëve më të ulëta, me misionin e vetëm që të sigurojë njësim dhe zhvillim të mëtejshëm të praktikës gjyqësore.

**Rekursi** është një akt për të kundërshtuar një vendim të një gjykate më të ulët në Gjykatën e Lartë.

Gjykata e Lartë i ushtron funksionet gjyqësore përmes kolegjeve të saj.

**Kolegji Civil**, shqyrton rekursat kundër vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, si dhe për çështje të tjera, të përcaktuara në ligj.

**Kolegji Penal**, shqyrton rekursat kundër vendimeve penale të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe nga gjykatat e posaçme për çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe për çështje të tjera, të përcaktuara në ligj.

**Kolegji Administrativ**, shqyrton rekursat kundër vendimeve të gjykatave administrative.

Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.



## GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

### QENDRA E DOKUMENTACIONIT PRANË GJYKATËS SË LARTË

Një pjesë thelbësore e transparencës dhe e aksesit në drejtësi ka të bëjë me ofrimin e mundësisë për qytetarët që të marrin lehtësisht informacion në lidhje me vendimet e gjykatës. Qendra e Dokumentacionit e ofron këtë shërbim në pajtim të plotë me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha vendimet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimin e pakicës, publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë si dhe Buletinin Periodik të Gjykatës. Ndërsa, vendimet e Gjykatës së Lartë për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore botohen edhe në Fletoren Zyrtare.

### KONTAKTONI GJYKATËN

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

-  Rr. Ibrahim Rugova Tiranë, Shqipëri
-  +355 4 2257304
-  [ida.vodica@gjykataelarte.gov.al](mailto:ida.vodica@gjykataelarte.gov.al)
-  [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)
-  <https://www.facebook.com/GjykataeLarte>
-  <https://www.linkedin.com/company/gjykata-e-lartë-e-republikës-së-shqipërisë/>